



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

I lidhur me datë: 31.05.2021, ndërmjet:

1. Komunës së Gjakovës, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës – Ardian Gjini, në tekstin vijues Komuna;
2. “Ansambli Muzikor i Komunës së Gjakovës”, të cilën e përfaqëson Pëllumb Vula, në tekstin vijues Ansambli;

Neni 1
Qëllimi

Ky Memorandum Bashkëpunimi ka për qëllim angazhimin e përbashkët në realizimin e projektit për koncertet e verës dhe për koncertin e dimrit për vitin 2021.

Neni 2
Obligimet e Komunës

- 3.1 Komuna e Gjakovës do të siguroj mjetet financiare në vlerë prej 13,800.00 euro për realizimin e plan projektit nga Ansambli Muzikor i Komunës – Orkestra Simfonike për koncertet e verës dhe dimrit për vitin 2021.
- 3.2 Mjetet që do të ndahen për organizimin e koncertit do të ekzekutohen pas pranimi të faturave e arsyeshmërive të shpenzimeve të cilat do të jenë të argumentuara nga “Ansambli”.
- 3.3. Mjetet në vlerë prej 13,800.00 euro do të ndahen nga kategoria mallra dhe shërbime e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.



Neni 3
Obligimet e “Ansambli-it”

4.1 Obligohet të sjellë faturat origjinale, arsyeshmëritë e shpenzimeve përmes së cilave do të pasqyrohen shpenzimet e bëra, lidhur me aktivitetin e saj.

4.2 Të gjitha faturat duhet të dorëzohen në organet e administratës komunale së bashku me llogarinë bankare.

Neni 4
Realizimi i koncertit festiv

5.1 Realizimi i plan projektit për koncertet për vitin 2021 nga “Ansambli” fillon me koncertin veror dhe përfundon me koncertin festiv të fundvitit që do të realizohen në Komunën e Gjakovës.

Neni 5


6.1 Ky memorandum i bashkëpunimit është i përpiluar në 4 (katër) ekzemplarë të njëjtë, prej të cilave nga dy ekzemplarë u dorëzohen palëve kontraktuese.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky Memorandum Bashkëpunimi paraqet vullnetin e lirë të palëve nënshkruese, të cilat zotohen se të njëjtin do ta zbatojnë në përpikmëri dhe në pajtim me kornizën ligjore në fuqi, ndërsa obligimet e palëve rrjedhin pas nënshkrimit të këtij Memorandumi.

P A L Ë T


Komuna e Gjakovës


Ardian Gjini



Ansambli Muzikor i Komunës së Gjakovës


Pëllumb Vula



ANSAMBLI MUZIKOR I
KOMUNËS SË GJAKOVËS
ORKESTRA SIMFONIKE

Plan projekti për koncertet

e vitit 2021

27.05.2021

Të nderuar !

Ansambli Muzikor i Komunës së Gjakovës – Orkestra Simfonike është institucion kulturorë i Komunës së Gjakovës, i themeluar në vitin 2013 në bazë të Ligjit 04/L – 164 . Fushëveprimi i tij bazohet në fushën e artit muzikor, konkretisht në përgatitjen dhe shfaqjen e koncerteve artistike, duke i sjellur publikut të Gjakovës muzikë të mirëfilltë profesionale. Qëllimi i tij është që të ngris nivelin artistik dhe të kultivojë shije të mirëfilltë muzikore tek publiku i Komunës sonë dhe më gjërë.

Nisur nga sukseset e pa diskutueshme të kësaj Orkestre si mbrenda dhe jasht vendit dhe numërit ç’do ditë e në rritje të instrumentistëve profesionistë që tani ka arritur në 45 instrumentist nga Gjakova, e po ashtu dhe numërit të madh të artëdashësve të cilët janë të rritje dhe ndjekin koncertet tona, i propozojmë Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit të Gjakovës që të mbështesin koncertet tona për vitin kalendarik 2021.

Për vitin kalendarik 2021 planifikojmë ti mbajmë katër koncerte, ku do të interpretohet nga një koncert për stinët - Pranverë, Vjeshtë dhe Dimër dhe secili nga këto koncerte do të jetë i ndryshëm për nga forma, struktura dhe përmbajtja.

Koncerti i Verës, planifikohet të mbahet në muajin Qershor dhe ky koncert do ti dedikohet kompozitorit E. Grig, Antonio Vivaldi si dhe kompozitoreve C.Zadeja dhe K. Laro dy keta kompozitorë shumë të dashur për publikun e Komunës së Gjakovës . Planifikohet të interpretohet muzikë me program që të jetë më e kuptueshme përpublikun të cilët nuk kanë edukim të avansuar muzikor. Programi që planifikohet të interpretohet do jetë: E.Grig Holberg Suite , A . Vivaldi “ Katër Stinët “,C. Jenkins, C. Zadeja Skenderbeu dhe K,Laro Liri a Vdekje.

Koncerti i Dimrit, ai festiv i Vitit të Ri, tani më tradicional planifikohet të mbahet në dhjetë ditët e fundit të vitit 2021 përkatësisht 18 – 28 Dhjetor . Në këtë koncert planifikohen të interpretohen veprat më të njohura të kompozitorëve klasikë të cilat janë të destinuara dhe të kompozuar me karakter festiv si psh: valse, polka, marshe, overtura të operave e poashtu edhe muzikë e filmave dhe grupeve të njohura Pop, Rock, etj.

Këto koncerte planifikohen të mbahen në sallën e Pallatit të Kulturës “ Asim Vokshi “dhe në ndonjeren nga platote e hapura open air ose ne sallën koncertale të Shkollës së Muzikës “Prenk Jakova” në Gjakovë, si dhe në njërin prej shesheve të hapura, gjithnjë në bashkëpunim të ngushtë me DKRS-në e Komunës së Gjakovës.

Duke pasur parasysh që në këto koncerte planifikohet të interpretohen vepra jashtzakonisht komplekse për nga natyra, për realizimin e tyre kërkohet angazhim më i madh i instrumenteve, ndërsa për interpretimin e tyre, më së paku duhet të angazhohen 45 Instrumentistë, përfshirë këtu dhe stafin përcjellës të cilët do të bëjnë të mundur realizimin e këtyre koncerteve.

Kostoja për realizimin e këtyre koncerteve është **13.800 €** dhe është planifikuar në minimum të shpenzimeve për kompensimin e 45 instrumentistëve dhe stafit teknik të angazhuar në këto

koncerte. Në realitet nëse marrim parasysh të vetmin institucion të përafërt në Kosovë – “Filharmonia e Kosovës”, e cila me këtë shumë realizon vetëm një koncert, rezulton që shumica e kërkuar është më se e arsyeshme. Duke qenë Orkestër në nivel të Komunës dhe me entuzjazmin e madh që kemi për punë, për shkak edhe të situatës me Covid-19 në konsultim dhe me këshillin artistik dhe antarët e orkestrës, jemi pajtuar që honoraret për instrumentistë të jenë në minimumin e mundshëm për një koncert.

Të nderuar, Ansambli Muzikor i Komunës së Gjakovës – Orkestra Simfonike është vlerë e padiskutueshme e Komunës sonë dhe njëherit ju informoj që Komuna jonë është e vetmja në nivel vendi që e ka një institucion të tillë, me një numër kaq të madh instrumentistësh profesionistë. Kjo është arritur falë punës së jashtëzakonshme që bëjnë profesorët dhe nxënësit e Shkollës së Muzikës “Preng Jakova” në Gjakovë, tani e 10 vjet dhe mbështetjes së institucioneve Komunale .

Tri koncerte në vit janë domosdoshmëri që orkestra të zhvillohet dhe të arrijë nivelin më të lartë interpretativ, ngase nëse krijohen pauza të gjata në mes të koncerteve, atëherë humb kompaktësia interpretative në mes instrumentistëve si dhe ndjenja e të interpretuarit së bashku.

Në emër të Institucionit të cilin e drejtoj, shfrytëzoj rastin të ju falendëroj dhe ju lutem për mbështetje financiare të këtij Institucioni !

Me respekt !

27.05.2021

u.d. i drejtorit
Pëllumb Vula



Pasqyra buxhetore për realizimin e koncerteve

Koncerti i Verës

Instrumentisëtë	30 x 100	3000
Dirigjenti	1 x 700	700
Solo Violina	1 x 200	200
Stafi teknik	3 x 100	300
Fotokopjimi I partiturave	1 x 100	100
Pllakata,Programi,Ftesat	1 x 200	200
Kontabilisti	1 x 200	200
Akordimi I pianos	1 x 100	100
Transorti	1x200	200
	totali	5000 €

Koncerti i Dimrit "I Vitit të Ri"

Instrumentistët	45 x 130	5850
Dirigjenti	1 x 700	700
Stagi teknik	2 x 200	200
Sigurimi i Partiturave Aranzhimi	1 x 200	200
Skenografia – Ndriqimi	1 x 800	800
Zerimi	1 x 200	200
Fotokopjimi i partiturave	1 x 200	200
Pllakatat, Programi Ftesat	1 x 350	350
Kontabilisti	1 x 200	200
Mirmembajta e xhirollogarise	1 x 100	100
	totali	8.800 €

u.d. i drejtorit

27.05.2021

Pëllumb Vula

Email.pellumb.vula@yahoo.com

Mob. 044998800

Nr.xhirollogarise XK051930001004051187

